Si ta regjistroj të drejtën pronësore që rrjedh nga vendimi i Gjykatës?

Kur gjykata ka vendosur për një mosmarrëveshje rreth të drejtave pronësore, gjykata mund ta nxjerrë një vendim me të cilin i përcakton të drejtat ligjore mbi pronën e paluajtshme. Personi, të drejtat pronësore të së cilit janë themeluar nga gjykata, duhet ta regjistrojë të drejtën e tij pronësore në Zyrën Kadastrale Komunale (ZKK).

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

SI TA REGJISTROJ TË DREJTËN PRONËSORE QË RRJEDH NGA VENDIMI I GJYKATËS?

Pse duhet ta regjistroj?

Siguria
Regjistrimi i pronës ju jep sigurinë ligjore.

Liria më e madhe
Kur të regjistrohet prona juaj, ju mund ta shitni më lehtë, mund ta ndani dhe mund t'ia leni fëmijëve tuaj.

Më shumë mundësi
Kur të regjistrohet prona juaj, ju mund të bëni kërkesë për t'a lënë atë në hipotekë apo të bëni kërkesë për ndonjë subvencion qeveria.



I. Regjistrimi i pronës në Zyrën Komunale Kadastrale (procesi zgjatë 1-3 ditë)

Në rrethanat kur një personi i është konfirmuar e drejta pronësore nga gjykata, ai person duhet t'i paraqesë dokumentet e mëposhtme pranë ZKK-së për regjistrimin e të drejtave të tij pronësore:

- Formularin e plotësuar të kërkesës,
- Vendimin zyrtar të gjykatës,
- Kopjen e letërnjoftimit të pronarit të ri,
- Kopjen e planit të pronës (që merret nga sektori i gjeodezisë në Zyrën Kadastrale Komunale me pagesë prej 5 €),
- Dëshminë e pagesës së tatimit në pronë (nga Zyra Komunale e Financave), dhe
- Pagesa e tarifës për regjistrim (50 €).

Koha e parashikuar për t'i mbledhur këto dokumente është 1-3 ditë.

Nuk keni nevojë që të shkoni tek noteri.

Çdo pagesë e tarifës ose taksës mbi 10 € duhet të bëhet në bankë dhe kërkohet dëshmia e pagesës bankare. Të gjitha pagesat nën 10 € paguhen në zyrën përkatëse.

II. ZKK-ja e kryen regjistrimin (procesi zgjatë 15 ditë)

ZKK-ja detyrohet me ligj që ta kryejë regjistrimin brenda pesëmbëdhjetë ditëve. Gjatë kësaj periudhe, njoftimi i transferimit të pronësisë postohet në tabelën e informatave të ZKK-së për pesë ditë. Pas miratimit të regjistrimit të ri, ZKK-ja e njofton pronarin e ri për të ardhur në ZKK për ta marrë kopjen e certifikatës së pronësisë.

Koha maksimale për ta kryer këtë proces vlerësohet të jetë 15 ditë.